



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1681, datë 08.09.2011

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1594, datë 04.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 08.09.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimi tadministartiv të filluar me VKD nr. 1594, datë 04.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a” të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, Pretendimet**);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1594, datë 04.05.2011 i KD të AKEP “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a”;
2. Shkresa e Vodafone Al me Ref. LDG/0180/AC, datë 19.5.2011, “Dërgohen prapësimet në kuadër të procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1594, datë 4.5.2011, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abcom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a.”, (AKEP: nr. 576/4 prot, date 20.05.2011)
3. Shkresa e Abcom sh.p.k me nr.354 prot, date 26.05.2011, “Dërgohen pretendimet e Abcom lidhur me procedimin administrativ Vendimi nr. 1594, date 04.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abcom sh.p.k dhe Vodafone Al sh.a”, (AKEP: 567/5 prot, date 26.05.2011);
4. Shkresa e Vodafone Al me ref: LDG/0217/AC, datë 3.6.2011 “ Plotësim i prapësimeve të Vodafone Al ;
5. Shkresa e AKEP nr. 1299 prot, datë 28.07.2011 “Mbi procedimin administrative për zgjidhje MI midis ABCom sh.p.k dhe Vodafone AL”;
6. Shkresa e ABCom sh.p.k nr. 435 prot, date 05.08.2011, drejtuar AKEP “Përgjigje Tuajës nr. 1299 prot, date 28.07.2011” (AKEP nr. 1299/1 prot, date 5.08.2011);
7. Shkresa Vodafone Albania sh.a. me Ref. LGD/0351/AC, datë 18.08.2011, “Përgjigje shkresës tuaj nr. 1299Prot., datë 28.07.2011, për dhënie informacioni mbi tarifën e terminimit fiks të pagueshme nga Vodafone Albania”;
8. Korrespondenca shkresore midis palëve,
9. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R Ë N:

- I. Vodafone me shkresën me Ref. LDG/0180/AC, datë 19.5.2011, “Dërgohen prapësimet në kuadër të procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1594, datë 4.5.2011, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abcom sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”, (AKEP: nr. 576/4 prot, date 20.05.2011) dhe ngre pretendimet si më poshtë:
1. Vodafone shpjegon se ka bërë të gjitha përpjekjet për të lidhur marrëveshjen e interkoneksionit mes palëve, por të gjitha kanë rezultuar të pasuksesshme për shkak të refuzimit të Abcom për të konkluduar negociatat brenda afateve ligjore. Vodafone jo vetëm ka iniciuar procesin, por ka qenë e gatshme të përgjigjet në kohë dhe i ka bërë kujtesa të vazhdueshme Abcom, qoftë me telefon, qoftë në formë të shkruar;
 2. Vodafone ka filluar negociatat me Abcom më datë 14.1.2011, duke prezantuar ORI-n e re, dhe duke këkuar firmosjen e marrëveshjes së re të interkoneksionit në përputhje me VKD nr. 1468, datë 23.12.2010;
 3. Nga Abcom sh.p.k., është konfirmuar depozitimi i garancisë financiare me datë 01.03.2011, duke konsumuar afatin ligjor prej 45 ditësh (për kryerjen e negociatave mes palëve) vetëm për depozitimin e garancisë;
 4. Abcom ende nuk ka plotësuar dokumentacionin ligjor të detyrueshëm paraprak për fillimin e negociatave sipas pikës 8/4, të ORI dhe Anekseve 4 (4.3 e 4.4) dhe 5;
 5. Njoftime të herëpashërëshme në lidhje me dokumentacionin e munguar janë bërë më datat 8 dhe 11 Prill. Ndërsa, me njoftimin e datës 15.04.2011, Vodafone i ka dërguar Abcom kërkesën për dorëzim të NSPC dhe dokumentin për seritë numerike, për të formalizuar MI si nga ana teknike dhe ligjore;
 6. Abcom, vazhdon të lëshojë fatura për shërbime interkoneksioni që prej muajit Shtator 2010, me tarifa të paligjshme, për të cilat nuk është rënë dakord mes palëve, duke shkelur haptazi MI e nënshkruar mes palëve.
 7. Abcom ka lëshuar fatura që nga java e parë e muajit Tetor, për shërbime interkoneksioni me çmim terminimi 3 lekë/min, dhe 0.09 lekë/thirrje, ç’ka është arbitrare dhe e paligjshme, pasi palët duke filluar nga 01.09.2010 deri më 28.02.2011, kanë rënë dakord dhe kanë nënshkruar amendimin përkatës për një tarifë terminimi 1.54 lekë/min dhe 0.046 lekë/thirrje;
 8. Për muajin Mars 2011, Abcom ka lëshuar një faturë me tarifë terminimi 3 lekë/min dhe 0.09 lekë/thirrje, kjo në vijim të sjelljes arbitrare pasi prej 01.03.2011, palët nuk kanë një MI në fuqi që të rregullojë të drejtat dhe detyrimet;
 9. Edhe pse në shkelje flagrante të MI mes palëve ku është rënë dakord për tarifën 1.54 lekë/min, Abcom ende nuk ka lëshuar një “credit note” për shlyerjen e këtij fitimi të padrejtë në kurriz të Vodafone;

10. Tarifa e propozuar nga Abcom, në negociatat mes palëve është krejtësisht antikompetitive e pabazuar në analizë kostoje dhe nuk i bën referencë krahasimore asnjë tarife në nivel rajonal dhe të BE-së., dhe si e tillë duhet çmuar në shkelje të ligjit.
11. Vodafone tarifën 1.54 lekë/min e ka propozuar ndaj të gjithë operatorëve të tjerë alternativë dhe e ka aplikuar në të gjithë marrëveshjet ekzistente që prej datës 01.04.2010. Ky është një trajtim jo-diskriminativ që Vodafone mban ndaj çdo operatori në përputhje me ligjin nr. 9918;
12. Marrëveshja pararendëse me Abcom është nënshkruar me tarifën e terminimit 1.54 lekë/min (01.09.2010-28.02.2011) kjo tregon që Abcom duhet të ketë kryer një lloj analize kostoje e cila e ka çuar të akordojë këtë çmim. Rritja pothuajse dyfish, e pabazuar në asnjë analizë reale kostoje (nuk i është vendosur në dispozicion Vodafone AI) është krejt e papranueshme;
13. Të gjitha seritë numerike të Abcom janë të alokuara në Tiranë dhe kjo me analogji i bën referencë segmentit lokal të terminimit në rrjetin fiks, tarifa e terminimit të të cilit (1.50 lekë/min sipas VKD së AKEP) është madje më e ulët se propozimi i Vodafone AI;
14. Kjo logjikë për lidhje MI me operatorët alternativë duke i bërë referencë njëtrajtshmërie tarifave të rregulluara operatorit fiks inkumbent është e njohur edhe në rajon si në Kroaci, Mal të zi, Bosnje Hercegovinë etj.
15. Tarifat e terminimit në BE dhe rajon, duke i'u referuar dokumentave rregullatorë dhe analizues të BE-së (*Enlargement countries monitoring report, June 2009, fq. 60*) janë shumë më të ulta se shifra që pretendon Abcom (3 tarifat për segment lokal, segment njëfish dhe segment dyfish). Referenca për tarifën e terminimit për segmentin dyfish, që mbart edhe koston më të madhe, është 1.16 Eurocent në mesataren e BE-së, pothuajse e barabartë me atë që propozon Vodafone, për tarifë të njëtrajtshme 1.54 lekë/min;
16. Dokumentat e lartpërmendur nuk i bëjnë për asnjë moment referencë tarifës për thirrje. Vodafone siç ka rënë dakord me operatorët e tjerë kërkon të njëjtën gjë edhe me Abcom. Kjo tarifë nuk ka bazë ligjore apo rregullatore për aplikim. Po ashtu, struktura e terminimit të OFNT në Shqipëri e bazuar në analizë kostoje nuk e njeh zbatimin e tarifës për thirrje;
17. Pretendimi i Abcom se ngritja e tarifave po influencohet për shkak të investimeve në rrjet, është argument jo në përputhje me kuadrin rregullator, jo-racional, i pabazuar në ligj dhe si i tillë mund të jetë i formës abuzive ndaj operatorëve dhe konsumatorëve (referuar: *recommendation of 07.05.2009 on Regulatory treatment of fixed and mobile termination rates in the EU*);
18. Tarifat e terminimit në BE vazhdojnë të shkojnë drejt uljes. Dokumentat rregullatore të BE-së shprehin qartazi se tarifat e terminimit në rrjetin e telefonisë fikse në Shqipëri janë reth 75 % më të larta se mesatarja e BE-së për segmentin njëfish dhe tre herë më të larta për segmentin dyfish, duke pranuar si të arsyeshme tarifën për segmentin lokal prej 1.5 lekë/min.

19. Për sa më sipër Vodafone edhe pse në mungesë të kontratës, ka treguar vullnet të mirë bashkëpunues, pa pezulluar shërbimin e interkoneksionit, duke respektuar frymën e ligjit nr. 9918, duke mundësuar shërbim për të gjithë pajtimtarët e të dy rrjeteve.
20. Sipas nenit 35, i ligjit nr. 9918, çdo tarifë që nuk orientohet në kosto është abuzive, shpërdoruese dhe antikonkurruese, si e tillë në shkelje të ligjit nr. 9918 dhe nr. 9121.
21. Gjithashtu Vodafone Al me anë të shkresën ref: LDG/0217/AC, datë 3.6.2011, ka sjellë plotësimin e prapësimeve, si më poshtë:

1. Vodafone, në përgjigje të ankimit të Abcom shprehet se i ka dërguar Abcom:

- Më dt. 14.01.2011, draft MI, e cila nuk ka patur tarifë terminimi të sugjeruar;
- Më datë 27.01.2011, drafti nuk ka patur tarifë terminimi të sugjeruar;
- më dt. 02.02.2011, draft MI, me tarifë terminimi 1,54 lekë/min, dhe 0,046 lekë/thirrje. Tarifë kjo e sugjeruar nga Vodafone për të qenë në të njëjtën linjë me operatorët e tjerë alternativë, që prej dt. 01.04.2010, dh eme qëndrimin e mëparshëm të Abcom;
- më dt. 24.02.2011, tarifa e terminimit e sugjeruar ka qenë 1.54 lekë/min, por është sugjeruar heqja e tarifës për thirrje në zbatim të VKD nr. 1505, dt. 10.02.2011.

Sa më lart, Vodafone për asnjë moment nuk ka propozuar tarifë terminimi të ndryshme nga 1.54 lekë/min.

2. në lidhje me argumentat tekniko-ekonomik, Vodafone shpreh se Abcom të vetmet argumente për përcaktimin e tarifës së terminimit janë:

- Plani i biznesit, për shtrirje në të ardhmen në rrethe të tjera (në Vlorë dhe Durrës);
- vendim i AKEP (anonim), për një asimetri të legjitimuar prej 30 % mes Operatorëve Alternativë (OA) dhe Albtelecom.

Sa i takon *pikës 1*, më lart Vodafone, sqaron se planet e ardhshme për zgjerim rrejtji nuk mund të justifikojnë kostot reale që mbart për momentin Abcom (*cituar edhe në pikën 18 më lart*). Megjithë pretendimet, Abcom nuk paraqiti një dokument mirëfilli teknik-ekonomik, në të cilin të shpreheshin të detajuar elementët që justifikojnë tarifën e pretenduar të terminimit.

Vodafone shpreh dyshimet për analizën e munguar të koston, duke vënë në dukje inkonsistencën e Abcom, në lidhje me tarifën e terminimit:

- për periudhën 01.09.2010-28.02.2011, Abcom ka pranuar tarifën 1.54 lekë/min;
- me emailin e dt. 01.03.2011, propozohet tarifa 3 lekë/min, dhe 0.83 lekë/thirrje;
- me emailin e dt. 02.03.2011, propozohet tarifa 2.5 lekë.min dhe 0.075 lekë/thirrje;

Këto luhatje të vlerës së tarifës së terminimit brenda një kohe të shkurtër, sipas Vodafon çojnë në dyshime për ekzistencën e një analize kostoje, apo në korrektësinë e profesionalizmin në përgatitjen e saj.

Në lidhje me pikën 2, më lart, referenca e Abcom është një dokument hipotetik i AKEP, që legjitimon një asimetri 30 %, në tarifën e terminimit mes OA dhe Albtelecom.

Vodafone, duke iu referuar dokumentit përfundimtar të analizës së tregut të telefonisë fikse, Korrik 2010, sqaron se:

- AKEP, nuk ka legjitimuar për asnjë çast asnjë lloj asimetrie në asnjë dokument rregullator, midis Albtelecom dhe OA;
 - Albtelecom dhe OA kanë gjetur dakortësi ndërmjet tyre për aplikimin e asimetrisë 30 % në tarifën e terminimit, por jo në terma detyrues të rregulluar në AKEP;
 - AKEP, është shprehur qartë se tarifatat e terminimit në OA janë objekt negociatash;
 - Asimetria mund të aplikohet vetëm për dy sipërmarrje që operojnë në të njëjtin treg. Por, kurrsesi nuk mund të aplikohet një masë diskriminuese që synon konkurrencën në treg, për dy lojtarë që në vetvete nuk janë konkurrentë në të njëjtin treg, pasi operojnë në dy tregje të ndryshme.
 - Në rast aplikimi, asimetria duhet të jetë e kufizuar qartësisht në kohë dhe të synojë simetri të plotë;
 - Kjo kërkesë e Abcom për implementimin e një detyrimi të tillë është totalisht e pajustificueshme dhe e pabazuar në ligj apo akt rregullator, kombëtar apo i BE;
 - Nga ana tjetër, Abcom nuk ka paraqitur asnjë kopje të dokumentit që vërteton përfundimin e negociatave me operatorë mobile, me çmimin e pretenduar.
3. Vodafone shprehet se vazhdon të mbajë linjë konseguente arsyetimi, gjë që del edhe nga përgjigjet përgjatë komunikimit, si dhe në prapësimet fillestare.
22. Vodafone Albania sh.a. me shkresën me Ref. LGD/0351/AC, datë 18.08.2011, “Përgjigje shkresës tuaj nr. 1299Prot., datë 28.07.2011, për dhënie informacioni mbi tarifatat e terminimit fiks të pagueshme nga Vodafone Albania”, informon se ka lidhur Marrëveshje Interkoneksioni me tarifë terminimi në rrjetet fikse prej 1.54 Lekë/min, me rreth 12 sipërmarrës që ofrojnë shërbim publik telefonik të qëndrueshëm.
23. Vodafone Albania sh.a. në përputhje me përcaktimet e Rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nenet 5, 6 dhe 7; ligjit nr. 8485 (K.Pr.A) dhe neneve 99 e 100 të ligjit nr. 9918, dhe nenit 60, i kërkon AKEP:
- Të zgjidhë mosmarrëveshjen me thelb tarifën e terminimit në interkoneksionin midis palëve, duke dhënë një Vendim përfundimtar mbi objektin e çështjes.
 - Të mbyllë procedimin administrativ dhe të lëshojë një Urdhër (sipas nenit 60, të ligjit nr. 9918) për lidhjen e marrëveshjes së re të interkoneksionit midis Vodafone Albania sh.a. dhe Abcom sh.p.k., ku të pasqyrohen tarifatat e terminimit prej 1.54 lekë/min dhe të mos aplikohet tarifë për thirrje.
- II.** Sipërmarrësi Abcom sh.p.k me shkresën nr.354 prot, date 26.05.2011, “Dërgohen pretendimet e Abcom lidhur me procedimin administrativ Vendimi nr. 1594, date 04.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abcom sh.p.k dhe Vodafone Al sh.a”, (AKEP: 567/5 prot, date 26.05.2011), sqaron si më poshtë vijon:

1. Abcom shprehet se, negociatat për të lidhur MI me Vodafone AL kanë filluar ne muajin Janar 2011, bazuar në kushtet e ORI të miratuar nga AKEP;
2. Vodafone AL filloi të zhvillojë bisedimet me Abcom për lidhjen e MI të re, pasi MI e mëparshme e lidhur midis palëve ka përfunduar dhe më date 1 Mars 2011 duhej të lidhej dhe hynte në fuqi MI e re;
3. Abcom konsideron se, në përputhje me legjislacionin në fuqi zbaton ne draft MI një tarifë terminimi në rrjetin e tij prej 2.5 lek/minute, ndërkoh Vodafone Al pa paraqitur ndonjë argument ligjor të qartë dhe të referuar në Ligj e kundërshton këtë tarifë dhe pretendon se Abcom duhet të zbatojë një tarifë terminimi më të ulët duke i bërë reference MI të mëparshme të lidhur midis palëve;
4. Abcom thekson se, palët kanë zhvilluar disa takime për përcaktimin e kësaj tarife, por nuk kanë aritur me një marrëveshje;
5. Abcom vlerëson se, në zbatim të nenit 31 të Ligj nr. 9918 datë 19.05.2008, tregjet të cilat janë subjekt i rregullimit janë tregjjet që nuk janë të orientuara drejt konkurrencës efektive Brenda një periudhe kohore të përshtatshme dhe ku zbatimi vetëm I ligjit për konkurrencën nuk mund të zgjidh në mënyrën e duhur dështimet e tregut. Subjektet të cilat kanë fuqi të ndjeshme në treg janë subjekt i masave të vendosura nga AKEP, ku një nga këto subjekte është dhe Vodafone AL;
6. Abcom konsideron se, po ti referohemi nenit 34 të Ligj nr. 9918, Vodafone AL nuk është në kuadër të konkurrencës efektive;
7. Gjithashtu Abcom argumenton se, neni 42 i Ligj sanksionon detyrimin e OFNT për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion dhe në veçanti të negociojë me dëshirën e mire dhe në mirëbesim me subjektet kërkues;
8. Abcom vëren se, Vodafone në kundërshtim me parimet e mësipër cituara ende nuk ka lidhur MI me Abcom dhe mosmarrëveshja qëndron pikërisht në tariffën e terminimit që Abcom kërkon për zbatim, në vlerë 2.5 lek/minute;
9. Abcom vlerëson se është e papranueshme që Vodafone AL të synojë të vendosë tariffën e terminimit për Abcom. Tarifa është e orientuar drejt kostos dhe e bazuar në argumenta ekonomik-financiare të Abcom si një operatorë jo FNT nuk janë të përcaktuara dhe të detyruara nga AKEP si organ rregullator, dhe në zbatim të nenit 59 të Ligj tarifat e shërbimeve duhet të jenë të orientuara drejt kostos efiçente duke mundësuar një normë të arsyeshme fitimi;
10. Abcom pretendon se, duke mos qënë operatore FNT është i lire në përcaktimin e tarifave të tij, duke patur si qëllim primar të ndjek veprime në interes të përdoruesve;
11. Abcom pretendon se, sipas Vendimit nr. 322, date 05.05.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të politikave për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” është pranuar tashme se hyrësit e rinjë të rrjeteve fikse përballen me vështirësi shumë të mëdha dhe janë të varur nga operatori incumbent;
12. Gjithashtu Abcom thekson se, në dokumentin e AKEP për analizën e tregut të telefonisë fikse është pranuar se operatorët alternative përfitojnë tarifa më të larta terminimi në

- rrjetet e tyre dhe se zakonisht palët kanë rënë dakort për asimetri 30% mbi tarifën e Albtelecom;
13. Abcom konsideron se, në përputhje me këtë analizë, tarifa e Abcom është krejt e arsyeshme në tregun aktual, abcom është operatorë I lire në treg dhe ka të drejtë të vendosë tarifën e tij sipas kushteve të veta tregtare;
 14. Abcom thekson se argumentat e Vodafone se, tarifa e zbatuar në MI e pëmëparshme ka qënë më e ulët nuk përbën detyrim ligjor për Abcom që tarifa për MI e re të jetë e njëjtë, gjithashtu argumenti se tarifa është antikompetitive është e pabazuar në ligj, sepse Vodafone nuk ka mundësi konkrete të gjykojë mbi kushtet ekonomike financiare mbi të cilat Abcom e ka përcaktuar këtë tarifë;
 15. Për gjithë sa më sipër Abcom i kërkon AKEP të ndërhyjë konform neneve 50 dhe 60 të Ligjit, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe nxjerrjen e një Urdhëri për lidhjen e MI midis Vodafone AL dhe Abcom sipas kërkesave ligjore në fuqi;
 16. AKEP me anë të shkresës nr. 1299 prot, datë 28.07.2011 “*Mbi procedimin administrative për zgjidhje MI midis ABCom sh.p.k dhe Vodafone AL*” i është drejtuar sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Vodafone AL, duke i’u kërkuar informacion shkresorë shtesë ABCom-it mbi tarifën e terminimit që aplikohet në rrjetin e tij me operatorët e tjerë dhe për Vodafone AL mbi tarifën e terminimit që aplikohet në rrjetin e operatorëve të tjerë;
 17. ABCom sh.p.k me anë të shkresës nr. 435 prot, date 05.08.2011, drejtuar AKEP “Përgjigje Tuajës nr. 1299 prot, date 28.07.2011” (AKEP nr. 1299/1 prot, date 5.08.2011) sqaron se:
 - ABCom ka lidhur Marrëveshje Interkoneksioni me Albtelecom sh.a dhe për përcaktimin e tarifave të terminimit i është referuar tarifave të terminimit në rrjetin e Albtelecom duke aplikuar një asimetri prej 30%. ABCom thekson se kostot e terminimit në rrjetin e ABCom janë më të larta se asimetria 30% e aplikuar;
 - Gjithashtu ABCom ka lidhur Marrëveshje Interkoneksioni me AMC duke përcaktuar tarifën për shërbim terminimi të thirrjeve kombëtare të dorëzuara nga AMC drejt abonteve të rrjetit ABCom, duke përfshirë thirrjet e origjinuara nga abonentët e AMC si dhe thirrjet e origjinuara nga abonentët e rrjeteve të tjera publike telefonike në RSH dhe që rregullisht janë të tranzituara nga AMC, në vlerën 2.5 lek/min;
 - ABCom thekson se nuk gëzon statusin e Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg, dhe i referohet Vendimeve të AKEP nr. 1663, 1664, 1665 dhe 1666 datë 28.07.2011 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të interkoneksionit midis Plus dhe OFNT-ve si AMC, Vodafone AL, Eagle Mobile dhe Albtelecom, me anë të të cilave AKEP ka pranuar të drejtën e operatorit jo me FNT Plus për përcaktimin e tarifës së terminimit nga ai vetë në rrjetin e tij, dhe se çështja që po trajtohet midis operatorit jo me FNT ABCom dhe Operatorit me FNT Vodafone AL është e njëjtë me çështjen e mësipërme;

III. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:

- a. Abcom është operatori alternativ që ka numrin më të madh të abonentëve të telefonisë fikse dhe që ka kryer investime të konsiderueshme në rrjet, përfshirë lidhjet direkte me abonentë fundorë, dhe që ka prezencën më të madhe gjeografike duke shtrirë rrjetin e abonentëve në qytetet kryesore të Shqipërisë. Pra investimet dhe aktiviteti i Abcom janë të përqëndruara në nivelin me pakicë, në ndryshim nga shumë operatorë alternativë që janë fokusuar në shërbimet me shumicë të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkomëbtare.
- b. Fakti që operatorët e tjerë alternativë kanë rënë dakort për tarifë terminimi 1.54 lek/minutë në rrjetet e tyre për interkoneksionin me Vodafone, nuk përbën detyrim për Abcom që të ketë të njetjën tarifë terminimi në rrjetin e tij si operatorët e tjerë, pasi këta operatorë kanë rënë dakort në negociata dhe kanë nënshkruar me vullnetin e tyre MI-të respective me Vodafone.
- c. Sipërmarrësi ABCom sh.p.k nuk është operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vlera e propozuar për terminim prej 2.5 lek/min (që është edhe si vlerë mesatare e tarifave të terminimit në rrjetin Abcom për thirrjet e përcjella nga Albtelecom: 1.95 dhe 3.25 lek/minutë) konsiderohet nga AKEP se është e arsyeshme për kushtet aktuale të tregut të telefonisë fikse dhe karakteristikat e rrjetit Abcom.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1594, datë 04.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a;
2. Tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin ABCom sh.p.k të jetë 2.5 lek/minute (pa TVSH);
3. Vodafone Albania të lidhë Marrëveshje Interkoneksioni me ABCom sh.p.k sipas Urdhërit bashkëngjitur;
4. Të njoftohen palët e interesuara ABCom sh.p.k dhe Vodafone AL sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: ëëë.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURÇE**